

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reagimi - Dënimi i ish krerëve të UÇK-së/ LDK: Djemtë dhe vajzat e UÇK-së mbrojtën pragun e shtëpisë
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/917052/denimi-i-ish-krereve-te-uck-se-ldk-djente-dhe-vajzat-e-uck-se-mbrojten-pragun-e-shtepise/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:28:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:55:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1a2b8426bba0cb228c2a1fbc871eac18da164edf3b9733c56951bfcc96e44e74
TEKSTI	e633a209666b72d74bdfb31808b10df6632e34bba7a7b5dda7700fa798ee5e48
PAMJA	353b21254b182278e54fa1382d9efaac58719cf256ba7ca155c48874fe91001d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	78dfc79f6fdd0b69c91593fb868de5a0719cdd743342b1fc8aa38f29c1836849
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06975047e5a3601e37e96e97bfab995ceed02fbc2c1535a000f7cb9180af2b1a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/78dfc79f6fdd0b69c91593fb868de5a0719cdd743342b1fc8aa38f29c1836849>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ILIR KALEMAJ

Dokrra hini dhe bota në tranzicion



ENVER BYTYÇI

Edi Rama edhe në varr nuk ndahet nga Aleksandër Vuçiq!



Dënimi i ish krerëve të UÇK-së/ LDK: Djemtë dhe vajzat e UÇK-së mbrojtën pragun e shtëpisë

12:55, 16/09/2026

Lidhja Demokratike e Kosovës ka reaguar pas aktgjykimit të sotëm ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke shprehur "shqetësim shumë të thellë" për vendimin dhe përmasën e dënimeve.

LDK-ja ka bërë thirrje për qetësi, maturi dhe përgjegjësi, duke theksuar se liria dhe pavarësia e Kosovës mbështeten në sakrificën e brezave, rezistencën politike e paqësore të udhëhequr nga Ibrahim Rugova, luftën e UÇK-së dhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NATO-s.

"Djemtë dhe vajzat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mbrojtën pragun e shtëpisë", thuhet në reagimin e LDK-së.

Partia ka deklaruar se asnjë aktgjykim, përfshirë atë të sotmin, nuk mund ta zhbëjë, sipas saj, të vërtetën historike të luftës në Kosovë. LDK-ja ka përmendur krimet e kryera nga regjimi i Serbisë gjatë luftës, përfshirë vrasjen e civilëve, dhunën, dëbimet dhe shkatërrimin e vendbanimeve.

Në reagim, LDK-ja ka ritheksuar përkushtimin ndaj shtetit të së drejtës dhe ka mbështetur "pa rezervë" shterimin e të gjitha kanaleve ankimore, përfshirë edhe ato të shkallës së dytë.

Po ashtu, LDK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve për qetësi e maturi, ndërsa përfaqësuesve politikë që të tregojnë përgjegjësi në fjalët dhe veprimet e tyre dhe të shmangin nxitjen e tensioneve.

"U bëjmë thirrje të gjitha forcave politike t'i lëmë mënjane ndasitë dhe të qëndrojmë bashkë për ta përballuar këtë periudhë të vështirë për Kosovën", thuhet në reagim.

Në fund, LDK-ja ka theksuar se UÇK-ja mbetet "pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë; dje, sot e përjetësisht"

© SYRI.net

Lexo edhe:



Dënimi i ish krerëve të UÇK-së/ BE-ja bën thirrje për përmajtje: Gjykata ta kryejë punën pa ndërhyrje

më të lexuarat

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

PDK dërgon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit

Gjykata Speciale: Katër të akuzuarit janë penalisht përgjegjës për krime lufte!

Kurti thirrje liderëve politikë: Ta zgjidhim çështjen e presidentit

Ndërron jetë Flora Brovina, nesër do të dëshmonte për Masakrën e Dubravës



Elshani:
Situatë e qetë
në veri, Policia
e gatshme të
reagojë në rast
incidentesh



Elshani: Situatë e qetë në veri, Policia e gatshme të reagojë në rast incidentesh

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim
për krime lufte

Edhe Jakup Krasniqi dënohet me 25 vjet
burgim

TË NGJASHME



VIDEO - FOTO/ Pamje tronditëse
nga trazirat në Hagë, mediat:
Demonstrata doli jashtë kontrollit



Dënohen 4 ish krerët e UÇK-së/ PDK:
Në Hagë u godit rëndë e drejta e
popullit që luftoi për liri, vendimi i
papranueshëm



Organizata e Veteranëve të Luftës:
UÇK s'ka qenë kurrë ndërmarrje
kriminale



Gucati: Nuk duhet t'i humbim
shpresat, mbetet apeli



Albulena Haxhiu: Dënimet janë
goditje e rëndë, fjala e fundit juridike
nuk është thënë



VIDEO/ Tensione në Hagë pas
verditit, policia hedh ujë për të
shpërndarë protestuesit

LAJME POLITIKE KRONIKE EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafii i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.